



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Valmirë Deliu	05.08.2024	13.08.2024	2024/0704

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.08.2024, OE “**EJONA**” SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0704, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Furnizimi, montimi dhe leshimi ne pune i ashensoreve te ri ne ndertesat qeveritare**” me nr. të prokurimit: “**214-24-1625-1-1-1**”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar: **procedurën e hapur**,

Lloji i kontratës: **furnizim**,

Vlera e parashikuar e kontratës: **259,240.00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit

Dhënia dhe nënshkrimi i kontratës

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 26

Nënshkrimi i kontratave publike

4. Personat e autorizuar që të nënshkruajnë sipas paragrafit 1. dhe 2. ose 3. të këtij neni mund të nënshkruajnë kontratën e tillë vetëm nëse përmbushen kushtet vijuese:

4.1. Së paku dhjetë (10) ditë kanë kaluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës; me kusht që, ky kusht të mos aplikohet për prokurimet urgjente që sipas nenit

35.2.1 (iii). Apo për një aktivitet të prokurimit të bazuar në nenin 36. Apo për kontrata me vlerë minimale;

4.2. Personat kanë konfirmuar edhe një here se informatat që gjinden në “Deklaratën e Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve” janë ende të sakta;

4.3. Personat nuk kanë pranuar asnjë komunikatë nga OSHP ose gjykata në të cilën thuhet se kontrata nuk duhet nënshkruar.

Interpretimi i KRPP:

4. 22.11.2022 4. 21.11.2022 Pas hyrjes në fuqi të Rregullores për Prokurimin Publik, cilët janë hapat që duhet ndjekur AK-të pas përfundimit të procesit të vlerësimit?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-099, KRPP ofron interpretimin ligjor, si në vijim:

Komisioni i vlerësimit përfundon vlerësimin e ofertave dhe rekomandon Operatorin Ekonomik për dhënie të kontratës.

1) Kërkohen nga OE i rekomanduar për kontratë dëshmitë për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë të specifikuara në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

2) Pas pranimit të dëshmimeve të pranueshmërisë, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit e nënshkruan raportin e vlerësimit dhe raporti ngarkohet në platformën e prokurimit elektronik.

3) Kërkohet nga ZKA dhe ZKF rikonfirmimi i Deklaratës së Nevojave dhe Disponueshmërisë se mjeteve.

4) Përgatitet Njoftimi mbi Vendimin e autoritetit Kontraktues (FS:B58) dhe publikohet në Sistemin e prokurimit nëpërmjet funksionit “Publikimi i B58”.

5) Periudha e pritjes – pritët 5 ditë për kërkesa për rishqyrtim (dita e publikimit është dita 0 e 5 ditëve të periudhës në pritje).

6) Nëse nuk ka kërkesa për rishqyrtim, përgatitet dhe publikohet në platformën elektronike Njoftimi për dhënie të kontratës/Njoftimi për Anulim të aktivitetit të prokurimit

7) Pas publikimit të Njoftimit për dhënie të kontratës, AK brenda 30 ditëve kalendarike nënshkruan kontratën.

8) Brenda dy dite pas nënshkrimit të kontratës, AK dërgon për publikim FS. B52 “Njoftim për

nënshkrimin e kontratës".

9) Nëse ka kërkesë për rishqyrtim, parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim automatikisht pezullon procedurën e prokurimit dhe në këtë rast ZP njofton të gjitha palët lidhur me pezullimin e procedurës në fjalë, shqyrton kërkesën, nxjerr vendimin dhe të njëjtin e publikon në sistemin e prokurimit elektronik.

PRETENDIMI 1)

AK ka shkelur Nenet e lartepermendura, duke shpallur jashteligjshëm "Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit"

Kronologjia e ngjarjeve të këtij aktiviteti është si më poshtë:

- 1) Më 17.05.2024 Jemi shpallur fitues nga AK
- 2) Më 27.05.2024 është shpallur "Njoftimi për dhenie të kontratës" me datën e planifikuar për nënshkrim me 29.05.2024
- 3) Më 05.06.2024 është ngarkuar në sistem Draft Kontrata dhe e kemi aprovuar të dyja palët.
- 4) Gjatë kësaj periudhe deri në njoftimin për anulim kemi pritur ftesën nga AK për nënshkrim të kontratës, ku përmes telefonatave në numrat zyrtar na është komentuar se janë në pritje të përgaditjes së kontratës dhe se shumë shpejtë do na therrasin për nënshkrim.
- 5) Më 17.07.2024 AK ngarkon në sistem pa asnjë paralajmërim "Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit" me arsyetimin:

"Arsye e anulimit të procedurës është, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenin 26 të Ligjit të Prokurimit Publik".

Pra, në mënyrë të jashteligjshme pa u përmbushur asnjë kusht për anulim, AK shpallë Njoftimin për Anulim të Aktivitetit gjatë periudhës sa kemi qenë në pritje për nënshkrim të kontratës, ku kompania jonë ka qenë në përgaditje për implementimin e kontratës. Asnjë kusht i vetëm nuk është plotësuar për Anulim të procedurës, ndërsa janë plotësuar të gjitha kushtet për nënshkrim të kontratës.

Ja rikujtojmë AK se nuk mund të thirret në paragrafin:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Pra, pretendimi i AK për anulim nuk është shkelje e ligjit që nuk mund të rregullohet!

Ajo mund të rregullohet me nënshkrim të kontratës nga zyrtarët përkatës!

Për këtë projekt, kompania jonë vecëse ka pasur shumë shpenzime ku kemi dërguar pjestarë të stafit në trajnime tek fabrika dhe kemi futur në porosi ashensorët për këtë projekt duke e ditur

rendesine e objekteve dhe per ti shmangur vonesat dhe parregullsitet.

Per keto kemi edhe prova qe do ti ofrojme gjate procedurave gjyqesore per kompensim te demit, ne rast se nuk kemi perkrahjen e OSHP ne kete lende.

E perserisim se:

Ne kete procedure nuk eshte plotesuar asnje kusht per anulimin e aktivitetit, si dhe jane plotesuar te gjitha kushtet per Nenshkrim te kontrates.

Ky eshte vendimi me qesharak qe kemi pare ndonjehere i leshuar nga nje Autoritet Kontraktues.

PERFUNDIM:

Kerkojme nga OSHP qe te Anuloje Njoftimin e jashteligjshem per Anulimin e Aktivitetit dhe te obligoje AK qe te vazhdoje me Nenshkrimin e Kontrates sipas LPP dhe sipas Njoftimit per Dhenie te Kontrates te dates 27.05.2024.

KRITERET PËR VLERËSIM

<p>c. Operatori ekonomik duhet të jetë i Certifikuar ose Licensuar nga Ministria e Tregtisë për Ashensor të Ri.</p>	<p>c. Certifikata ose licenca valide - kopje</p>
<p>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</p> <p>a. Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues, së qarkullimi vjetor (të hyrat) e OE gjatë tri viteve (2021, 2022, 2023) kanë qenë jo më pak se 450,000.00 €. Në rast të pjesëmarrjes si Grup i OE-vë, Lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të këtij qarkullimi minimal.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>a. Kopjet e Deklaratave Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore ose nga vendi i origjinës.</p>
<p>III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:</p> <p>1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte kontrata në lëmin e furnizimeve të ngjashme për periudhën e shkuar trevjeçare në vlerë prej të gjitha së bashku jo më pak së 350,000.00 Euro. Në rast të pjesëmarrjes si Grup i OE-vë, Lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të këtij realizimi minimal të projekteve kontratave.</p> <p>2. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ketë Staf profesional Një (1) Menaxher të projektit i cili duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master në Inxhinieri Mekanike drejtimi - Makineri - min. 5 vjet përvojë punë pas diplomimit dhe përvojë në menaxhimin e sepaku 1 projekti të ngjashëm të perfunduara.</p> <p>3. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Elektronikës - min. 5 vjet përvojë punë pas diplomimit.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>1. Lista e projekteve kontratave të përfunduara e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projekte e realizuara, duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të furnizimeve duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit. Kur furnizimet janë realizuar për autoritetin publik, si dëshmi për këtë realizim të furnizimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) ose referencës përkatëse të lëshuar nga autoriteti i tillë publik, për kontratat projektet e cekura në listë; dhe kur fur janë realizuar për blerësin privat, dëshmi për këtë realizim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë, për kontratat dhe projektet e cekura në listë.</p> <p>2. Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Për menaxherin e Projektit të paraqiten Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali , CV , kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi, Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje).</p> <p>3. Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali , CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës për këtë projekt me</p>

	punëdhënësin dhe Letër referencë nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar–(Kopje).
4. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë së paku tre (3) teknik të makinerisë.	4. Për teknike Certifikatat ose Dipomatë profesionale përkatëse kopje të noterizara nga origjinali, CV , kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt.
5. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë së paku dy (2) teknik të elektroteknikës.	5. Për teknike Certifikatat ose Dipomatë profesionale përkatëse kopje të noterizara nga origjinali, CV , kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

RAPORTI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Procedura e hapur
Procedurë e hapur; Vlerë e madhe

Në bazë të nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data kur është përgatitur Raporti i Vlerësimit: 14.05.2024

Nr. i prokurimit ¹	214-24-1625-1-1-1
Nr i brendshëm	

Titulli: Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË ADMINISTRATIVE TË TENDERËVE

Nëse tenderi është dorëzuar nga një grup i operatorëve ekonomik

Kërkesat formale/administrative të përcaktuara në Dosjen e Tenderit											
	Identifikimi i qartë i tenderuesit				Formulari i paraqitjes së tenderit i plotësuar dhe i nënshkruar si duhet	Kopje	Sigurimi i tenderit në pajtueshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit	Vlefshmëria e tenderit 90 ditë / muaj / data deri	Deklaratë e cila deklaron nënkontraktuesin e zgjedhur	Kërkesa të tjera formale/administrative (në specifikim)	TENDER I PËRGJEGJSHËM ME KËRKESAT ADMINISTRATIVE POIJO
	TENDERUESI (Emri, Adresa, Numri fiskal)	Nëse tenderi është dorëzuar nga një grup i operatorëve ekonomik									
		Deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkëdhënësit dhe individualisht përgjegjës	Deklaratë e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmimin të përdorimit	Deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të përbashkët udhëheqës							
1.	"EJONA" SH.P.K. Zahag, Peja 810089913	N/A	N/A	N/A	Po	Po	Po	90 ditë	Nuk kërko het		Po
2.	Uplift L.L.C. Rruga Vicianum, Prishtinë 811856965	N/A	N/A	N/A	Po	Po	Po	90 ditë	Nuk kërko het		Po

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve- procedura e hapur

2

Siguria e tenderit

	TENDERUESI	Forma e sigurisë së tenderit	Vlera e sigurisë së tenderit	Sigurimi i tenderit të vlefshëm derime	Emetuesi i sigurisë së tenderit	Informacione të tjera në lidhje me sigurimin e tenderit
1.	"EJONA" SH.P.K. Zahag, Peja 810089913	Bondi të sigurisë, të lëshuar nga një kompani sigurimit	7,000.00 EUR	17.08.2024	EUROSIG	
2.	Uplift L.L.C. Rruga Vicianum, Prishtinë 811856965	Bondi të sigurisë, të lëshuar nga një kompani sigurimit	7,000.00 EUR	17.08.2024	SCARDIAN	

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E PRANUSHMËRISË

Dokument	Uplift L.L.C.	"EJONA" SH.P.K.
a. Operatori ekonomik duhet të përmbushë kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Nenin 65 të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L- 068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim
b. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.	Në pajtim	Në pajtim
c. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbushë "Kërkesat e përshtatshmërisë" - që jeto i lëshuar së paku në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.	Në pajtim	Në pajtim
d. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit, që vërteton se tenderuesi i përmbushë "Kërkesat e pranueshmërisë", se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile, i cili dokument duhet të jetë jo me i vjetër se 3 muaj para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.	Në pajtim	Në pajtim

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve- procedura e hapur

3

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë e pranushmërisë:

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRISË PROFESIONALE TË TENDERËVE

Dokumenti	Uplift L.L.C.	"EJONA" SH.P.K.
	Ne pajtim / Nuk është në pajtim	Ne pajtim / Nuk është në pajtim
a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimit si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit me informata mbi biznesin dhe veprimtarinë. Për Operatorin Ekonomik jo rezident në Kosovë, nëse shpërblehet me kontratë, para nënshkrimit të kontratës, është i obliguar që ta regjistrojë përfaqësinë e biznesit në Republikën e Kosovës.	Në pajtim	Në pajtim
b. Deklaratë e TVSH-së, (për kompanitë vendore).	Në pajtim	Në pajtim
c. Operatori ekonomik duhet të jetë i Certifikuar ose Licensuar nga Ministria e Tregtisë për Ashensor të Ri.	Në pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë profesionale:

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR GJENDJEN EKONOMIKE & FINANCIARE

Dokumenti	Uplift L.L.C.	"EJONA" SH.P.K.
	Ne pajtim / Nuk është në pajtim	Ne pajtim / Nuk është në pajtim
a. Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues, së qarkullimi vjetor (të hyrat) e OE gjatë tri vjeve (2021, 2022, 2023) kanë qenë jo më pak se 450,000.00 €. Në rast të pjesëmarrjes si Grup i OE-vë, Lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të këtij qarkullimi minimal.	Në pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare:

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E AFTËSIVE PROFESIONALE TË TENDERËVE

Dokumenti	Uplift L.L.C.	"EJONA" SH.P.K.
	Ne pajtim / Nuk është në pajtim	Ne pajtim / Nuk është në pajtim
1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte kontrata në lëmin e furnizimeve të ngjashme për periudhën e shëruar trevjeçare në vlerë prej të gjitha së bashku jo më pak se 350,000.00 Euro. Në rast të pjesëmarrjes si Grup i OE-vë, Lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të këtij realizimi minimal të projekteve kontratave.	Në pajtim	Në pajtim
2. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ketë Staf profesional Një (1) Menaxher të projektit i cili duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar ose Master në Inxhinieri Mekanike drejtimi - Makineri - min. 5 vjet përvojë punë pas diplomimit dhe përvojë në menaxhimin e sepaku 1 projekti të ngjashëm të përfunduar.	I papajueshëm	Në pajtim
3. Një (1) Inxhinier i Diplomuar ose Master i Elektrikës - min. 5 vjet përvojë punë pas diplomimit.	Në pajtim	Në pajtim
4. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë së paku tre (3) teknika të makinerisë.	Në pajtim	Në pajtim
5. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë së paku dy (2) teknika të elektroteknikës.	Në pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

Operatori Ekonomik Uplift L.L.C., Rruga Vicianum, 10000, Prishtinë, Kosovë

Nuk ka përmbushur Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2

Kërkesa nr. 2

Për menaxherin e Projektit nuk kemi dorëzuar Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi fari sipas kërkesës së AK-së.

LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë

Sipas Nenit 60.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Kjo listë duhet të largohet nga raporti, në qoftë se kriter për dhënien e kontratës është përcaktuar "Tenderi përgjegjës ekonomikisht më i favorshëm".

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "EJONA" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare" me numër të prokurimit: "214-24-1625-1-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Radhë	Lënda / grupi: Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	"EJONA" SH.P.K., 810089913	179,744.44

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr.	Grupi:
1	Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare
	Emri i tenderuesit të suksesshëm
	Kodi postar
	Adresa
	"EJONA" SH.P.K., 810089913
	30000
	Zahaq

DEKLARATË

Komisioni i vlerësimit krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave, për tenderin Titulli i AP: "Renovimi i ashensorëve në ndërtesat qeveritare dhe pallat të drejtësisë", pas shqyrtimit të tërësishëm të dokumentacionit të dorëzuar nga tenderuesit në tenderët e tyre, duke u bazuar në kriterin për dhënien të kontratës të përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit, (Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët), i rekomandojnë zyrtarisht përgjegjës të prokurimit, që me këtë kontratë të shpërblehet tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët të tenderuesit, Operatori Ekonomik "EJONA" SH.P.K., Zahaq, 30000, Peja, në vlerë totale të ofertës në shumë prej: 179,744.44€.

PROCESVERBALI PËR EKZAMINIMIN, VLERËSIMIN DHE KRAHASIMIN E TENDERËVE

Në procesverbal, komisioni vlerësues duhet të jep informacione në detaje lidhur me përmbajtjen e secilit tender duke u bazuar në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë administrative:

1.	"EJONA" SH.P.K. 810089913	
2.	Uplift L.L.C. 811856965	

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve" - procedura e hapur

6

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë teknike:

Analiza e çmimit

	TENDERUESI	Informata në lidhje me gabimet në llogaritje	Arsyet për refuzimin e tenderit për shkak të çmimit anormalisht të ulët
1.	"EJONA" SH.P.K. 810089913		
2.	Uplift L.L.C. 811856965		

Informata shtese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit

	TENDERUESI	Informata shtese mbi sqarimet dhe shtojca e tenderit
1.	"EJONA" SH.P.K. 810089913	Për të vlerësuar tenderin e këtij tenderuesi në mënyrë të duhur, bazuar në nenin 59 dhe 72 të LPP-së, kemi kërkuar sqarime shtesë dhe të njëjtat janë ofruar në harmoni me LPP-në dhe kërkesat e AK-së, të cilat janë pjesë e kësaj dosje. Komisioni gjithashtu ka kërkuar nga OE të siell dokumentacionin të cilin e ka të ngarkuar në e-prokurim së bashku me ofertën për stafin Teknik të Makinerisë dhe Teknik të Elektroteknikës, këto dokumente së sjell në origjinal (noterizimet e diplomave ose certifikatave) për shikim të këtyre dokumenteve sepse kishim paqartësi në disa dokumente dhe pas dorëzimit në origjinal komisioni konsideron që janë në rregull.
2.	Uplift L.L.C. 811856965	

Vërejtje përmblyëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Komisioni i vlerësimit krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave, për tenderin me Titull: "Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare", pas shqyrtimit të tërësishëm të dokumentacionit të dorëzuar nga tenderuesit në tenderët e tyre, duke u bazuar në

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve" - procedura e hapur

7

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "EJONA" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare" me numër të prokurimit: "214-24-1625-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

kriterin për dhënien të kontratës të përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit, (Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët), për këtë AP janë pranuar gjithsej dy oferta pas analizimit të dokumentacionit kemi vetëm një ofertë të përgjegjshme dhe i rekomandojmë zyrtarit përgjegjës të prokurimit, që me këtë kontratë të shpërblehet tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët të tenderuesit, Operatori Ekonomik "EJONA" SH.P.K., Zahaq, 30000, Peja, në vlerë totale të ofertës në shumë prej: 179,744.44€.

DËSHMITË LIDHUR ME KËRKESAT E PRANUESHMËRISË²

Emri i Tenderuesit të cilit Autoriteti Kontraktues ka ndërmend ndër mend që t'ia jap kontratën	Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë				Është shpërblyer me kontratë PO/JO
	PO/JO				
	Certifikata nga Administrata Tatimore	Certifikata nga autoriteti kompetent gjyqësor apo administrativ	Certifikata nga autoriteti kompetent gjyqësor apo administrative – për drejtuesit e OE	Kërkesa të tjera te pranueshmërisë (Sigurimi i tenderit)	
"EJONA" SH.P.K. 810089913	PO	PO	PO	PO	PO

Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit: Agim Ismaili

Nënshkrimi: [Signature]

Data: 17/05/2024

² Të kërkohej vetëm nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndërmend që t'ia jap kontratën.

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

8

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit

Nënshkrimi

Esat Muliqi

Bujar Grajqevci

Armend Rugova

[Signature]
[Signature]
[Signature]

Data: 14.05.2024

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

9

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - " **EJONA " SH.P.K.**

Me datën: 02.08.2024, OE “**EJONA " SH.P.K.**”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0704, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Furnizimi, montimi dhe lëshimi ne pune i ashensoreve te ri ne ndertesat qeveritare**” me nr. të prokurimit: “**214-24-1625-1-1-1**”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar: **procedurën e hapur**,

Lloji i kontratës: **furnizim**,

Vlera e parashikuar e kontratës: **259,240.00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

- Autoriteti Kontraktues **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME**, ka zhvilluar Aktivitetin e Prokurimit me titull: : “**Furnizimi, montimi dhe lëshimi ne pune i ashensoreve te ri ne ndertesat qeveritare**”, me nr. të prokurimit: “**214-24-1625-1-1-1**”.
- Publikimi i njoftimit për kontratë është bërë me datë: **07.03.2024**.
- Hapja e ofertave është bërë me datë: **18.04.2024** ora: **14:00:00**.
- Njoftimi mbi vendimin e AK-së është bërë me datë: **17.05.2024**.
- Njoftim për dhënie të kontratës është bërë me datë: **27.05.2024**.
- Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit është bërë me datë: **16.07.2024**.
- Me datë: **18.07.2024**, operatori ekonomik: “**EJONA " SH.P.K.**”- Prishtinë, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim pranë AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME**.
- **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME**, me datë: **23.07.2024**, mori **Vendim për Refuzimin** e kërkesës të ri-shqyrtimit të OE “**EJONA " SH.P.K.**”- Prishtinë.
- Operatori ekonomik pas refuzimit të kërkesës për ri-shqyrtim nga AK, me datë: **02.08.2024**, ka parashtruar Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim Publik.
- Operatori ekonomik: OE “**EJONA " SH.P.K.**”- Prishtinë në Ankesën e parashtruar pranë Organit Shqyrtues për Prokurim Publik, i ka paraqitur pretendimet e tij.
- Eksperti Shqyrtues pas pranimit të lëndës për ekspertizë, i ka analizuar të gjitha

pretendimet e OE Ankues, dhe i ka trajtuar me kujdes duke i'u referuar legjislacionit.

Përgjigje në pretendimet ankimore

I pakënaqur me vendimin e AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME, Operatori Ekonomik ankues "EJONA" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 18.07.2024, kërkesë kjo e cila është refuzuar si e bazuar.

OE pretendon se AK me Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit, ka bërë shkelje të nenit 43 dhe nenit 62 të LPP-së si dhe nenit 26 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME, me datë 17.05.2024 kishte publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, në të cilin ishte shpërblyer me kontratë OE, "EJONA" SH.P.K." në vlerë prej 179,7444.44 €. Me datë 27.05.2024, AK kishte publikuar njoftimin për dhënie të kontratës dhe kishte planifikuar nënshkrimin e kontratës me datë 29.05.2024. Në vijim, me datë 05.06.2024, AK ngarkon në platformën e-prokurimi Draft kontratën e cila aprovohet nga të dyja palët. Gjatë kohës sa ka qenë në pritje të nënshkrimit të kontratës, AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME me datë 17.07.2024 ngarkon në platformën e-prokurimi, pa asnjë paralajmërim "Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit" me arsyetimin: "Arsye e anulimit të procedurës është, sepse nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenit 26 të Ligjit të Prokurimit Publik".

OE ankues më këtë veprim pretendon se AK ka anuluar procedurën e prokurimit në mënyrë të jashtëligjshme dhe pa u përmbushë asnjë kusht për anulim.

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të tërë dokumentacionit si dhe shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë ka vërejtur se mungojnë detaje që lidhen me njoftimin mbi anulimin e procedurës së prokurimit. Arsye e anulimit të procedurës në Njoftimin mbi Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit nga ana e AK-së është thënë të jetë se nuk janë plotësuar kushtet sipas kërkesave të paragrafit 2 të nenit 26 të Ligjit të Prokurimit Publik, i cili thotë si në vazhdim:

2. Përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik. Nga kjo rregull përjashtohet Presidenti, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri. Nënshkrimet e përcaktuara sipas këtij Neni, konfirmojnë dhe pranojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë. Kontratat që nuk nënshkruhen në pajtim me paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni janë të pazbatueshme.

Duke pas parasysh se AK nuk ka dhënë informacione të mjaftueshme mbi anulimin e procedurës së prokurimit, eksperti shqyrtues ka dërguar kërkesë për informacion shtesë pranë AK-së përkatësisht Divizionit të Prokurimit, prej të cilëve është kërkuar të sqarohet se cila prej pikave të paragrafit 4 të nenit 26 të LPP-së nuk janë plotësuar që kontrata të nënshkruhet apo ndonjë arsye tjetër, ndonjë dokument, që lidhet me njoftimin mbi anulimin e procedurës së prokurimit.

Në përgjigjen e tij ZPP i AK-së ka pohuar se, ka pranuar një e-mail me të cilin është njoftuar për mosnënshkrim të kontratës nga ana e ZKA-së dhe Ministrit, më arsyet si në

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "EJONA" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare" me numër të prokurimit: "214-24-1625-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

vijim:



Fri 8/9/2024 3:36 PM

Agim Islami

RE: Eksperti i OSHP-se/Kërkesë për informacion shtesë

To Valmira Deliu.Bucaj; Armend Rugova

Retention Policy DelFiveYOIdEm (5 years)

Expires 8/8/2029

Ju informojmë se ne njoftimin për anulim të këtij aktiviteti paska mbetur gabim teknik paragrafi 4 i nenit 26 sepse është paragrafi 2 i nenit 26, anulimi është bere për shkak se kontrata nuk është nënshkruar sipas kërkesave të këtij neni citat: Përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik.

Kontrata nuk është nënshkruar nga ZKA dhe Ministri dhe e njëjta është kthyer në Prokurim e pa nënshkruar me arsyet me poshtë të dërguara në email zyrtar nga ZKA;

Njoftim për mos nënshkrim të kontratës!

I nderuar,

Si jeni në dijeni, kemi pranuar nga Divizioni i Prokurimit kontratën me titull "Furnizimi, montimi dhe lëshimi në punë i ashensorëve të ri në ndërtesat qeveritare" me nr. 214-24-1625-1-1-1. për nënshkrim nga Sekretarja dhe Ministri.

Gjatë analizës së dosjes, kemi hasur në parregullsi dhe lëshime si nga njësi kërkesë ashtu edhe nga Divizioni i prokurimit dhe OE i rekomanduar.

Kemi konstatuar që:

Nuk është kërkuar e as prezantuar Autorizimi nga prodhuesi;

Si dëshmi e garancisë (e kërkuar 12 muaj në dosje të tenderit) është prezantuar deklarata e OE;

Nuk është kërkuar e as prezantuar se paku katalogu i ashensorëve;

Nga të gjeturat e sipërsënuara, dhe duke pasur në konsideratë problemet e vazhduara me ashensorë, që ndërliiden kryesisht me këto shkaqe, nuk do të nënshkruaj dhe nuk do të procedoj tutje për nënshkrim nga Ministri kontratën e lartcekur.

Andaj ju lutem i merrni të gjitha masat që kjo procedure të ri inicihet me korrigjimet e plotësimet përkatëse.

Me respekt

Agim Islami

Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit

Ministria e Punëve të Brendshme

Republika e Kosovës, 10000 - Prishtinë

Tel: 038 200 76 632

email: Agim.Islami@rks-qov.net

Pas përgjigjeve të pranura nga ZPP i AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, Eksperti shqyrtues sqaron se përfundimin (anulimin) e një Aktiviteti të Prokurimit e parasheh neni 62 i LPP-ës dhe neni 43 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik.

Bazuar në dispozitat e neneve të lartë përmendura përfundimi (anulimi) i një Aktiviteti të Prokurimit mund të ndodh para dhe pas hapjes së Tenderëve për njërin nga arsyet e përmendura në nenet e më sipërme dhe në asnjë mënyrë në fazën në të cilën gjendeni ju si ministri e aq më pak për arsyet e dhëna me e-mail (**Nuk është kërkuar e as prezantuar Autorizimi nga prodhuesi; Si dëshmi e garancisë e kërkuar 12 muaj në dosje të tenderit) është prezantuar deklarata e OE; dhe Nuk është kërkuar e as prezantuar se paku katalogu i ashensorëve;**) kur dihet që legjislacioni i prokurimit Publik kërkon që kërkesat, kriteret e vendosura në DT të jenë sa ma minimale, të mos ulin konkurrencën, të mos jenë diskriminuese dhe/ose favorizuese dhe kur thuhet qartë në paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së se:

"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e

kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Ndërsa sa i përket nënshkrimit të Kontratave të parapara në nenin 26 të LPP-së.

Personat e autorizuar që të nënshkruajnë kontratat ***mund të mos bëjnë një gjë të tillë vetëm nëse nuk janë plotësuar kushtet në vijim:***

- 1. Së paku dhjetë (10) ditë kanë kaluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës; me kusht që, ky kusht të mos aplikohet për prokurimet urgjente që sipas nenit 35.2.1 (iii). Apo për një aktivitet të prokurimit të bazuar në nenin 36. Apo për kontrata me vlerë minimale;*
- 2. Personat kanë konfirmuar edhe një here se informatat që gjinden në “Deklaratën e Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve” janë ende të sakta;*
- 3. Personat nuk kanë pranuar asnjë komunikatë nga OSHP ose gjykata në të cilën thuhet se kontrata nuk duhet nënshkruar.*

Duke marrë parasysh paragrafët e lartë cekura arsyetimi i ZKA-së dhe Ministrit nuk ka bazë ligjore që të anulohet procedurën.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe AK-së të trajtoj lëndën në pajtim me paragrafit 2 dhe paragrafit 4 të nenit 26 të LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **"EJONA" SH.P.K.**

Valmirë Deliu

Valmirë Deliu

